

Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Pika 1	Mësuesit dhe nxënësit nuk disponojnë telefon celular në mjediset e institucionit arsimor.		
Pika 2, Gërma a	Drejtoria e institucionit arsimor, kur është konstatuar disponimi i telefonit celular nga nxënësit në mjediset e institucionit, ka sekuestruar telefonin celular dhe ka zbatuar masën disiplinore, sipas kuadrit në fuqi. Telefonat e sekuestruar janë depozituar pranë ZVAP-it.		
Pika 2, Gërma b	Drejtoria e institucionit arsimor ka njoftuar me shkrim prindin ose kujdestarin ligjor të nxënësit, për masën e marrë ndaj nxënësit.		
Pika 3, Gërma a	Drejtoria e institucionit arsimor ka rishikuar rregulloren e brendshme të shkollës, si dhe ka përcaktuar masat për ndalimin e telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit në mjediset e institucionit arsimor.		
Pika 3, Gërma b	Drejtoria e institucionit arsimor ka organizuar takime me prindërit, për t’i njohur me rregulloren e re.		
Pika 3, Gërma c	Drejtoria e institucionit arsimor ka vendosur në çdo klasë poster për ndalimin e telefonit celular.		
Pika 3, Gërma d	Drejtoria e institucionit arsimor ka siguruar nënshkrimin e deklaratës së përbashkët të mësuesit të klasës me prindin ose kujdestarin ligjor, për ndalimin e telefonit celular në mjediset e shkollës nga nxënësit.		
Pika 3, Gërma e	Drejtoria e institucionit arsimor ka vënë në dispozicion numër telefoni të veçantë për komunikimin me prindërit e nxënësve dhe ua ka bërë me dije prindërve në deklaratën e përbashkët.		
Pika 3, Gërma f	Drejtoria e institucionit arsimor ka raportuar me shkrim pranë ZVAP-it për masat e marra ndaj mësuesit, në rast të përdorimit të telefonit celular gjatë procesit mësimor.		
Pika 4, Gërma a	ZVAP-i ka monitoruar masat e marra nga institucionet arsimore, për ndalimin e telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit, në mjediset shkollore.		
Pika 4, Gërma b	ZVAP-i ka depozituar pranë Policisë së Shtetit, telefonat celularë të sekuestruar nga shkollat.		
Pika 4, Gërma c	ZVAP-i ka raportuar çdo muaj me shkrim në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij udhëzimi.		